



FTESË PËR OFERTE

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

SOS Fshatrat e Fëmijëve për nevojat e projektit regjional “Fuqizimi dhe aftësimi të rinjëve përmes mundësive të reja – YEEP II”, projekt ky i cili zbatohet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë në Maqedoninë Veriore, Shqipëri, Bosne e Hercegovinë, Serbi dhe në Kosovë, i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimor - BMZ dhe Fondit Hermann Gmeiner Gjermani – HGFD i cili ka për qëllim të permirësojë mundësitë për punësim dhe pjesëmarrje aktive të të rinjëve në rrezik në tregun e punës, fton kompanitë e specializuara dhe të interesuara për të ofertuar për: marrjen e një veture

me qira (rent) për periudhë kohore: Shkurt 2024- Nëntor 2026

Me këtë rast shpallim Ftesë për Ofertë për të gjitha kompanitë e autorizuar për dhënjën me qera të veturave

SPECIFIKACIONI PËR VETURE

- Veturë me kilometrazhë jo me shume se 50 mije kilometra te kaluara
 - Marshi: Automatik
 - Karburanti: Diesel/ Benzinë/ Hibrid
 - Motori: 1.4 – 2.0 Kubik
 - Ngjyra: e bardhë; (e preferuar)
 - Vetura të ketë 5 dyer
 - Të posedojë AC klimë automatike
1. Sigurimi TPL dhe TPL+ dhe regjistrimi i veturës duhet të bëhet nga ana e Qiradhënësit
 2. Vetura duhet të ketë sigurimin KASKO
 3. Servisimi dhe mirëmbajtja e veturës duhet të bëhet nga Qiradhënësi
 4. Ndërimi i gomave (verë- dimër) duhet të bëhet nga Qiradhënësi
 5. Në rast të dëmtimit apo prishjes së veturës të sigurohet zëvendësimi nga Qiradhënësi
 6. Vetura duhet të ketë asistencë rrugore 24/7
 7. Vetura duhet të ketë navigacion GPS me harta të Kosovës dhe vendeve fqinje;
 8. Vetura duhet të ketë kartonin jeshil, dokument për të udhëtuar në një shtet tjetër pa pagesë;
 9. Komploti emergjent i makinës i përditësuar (ndihma e parë);
 10. Nuk duhet të ketë tarifa për anulim;
 11. Nuk duhet të ketë tarifa shtesë për kalimin e kufirit apo pirjen e duhanit brenda automjetit me qira.
 12. Afati i liferimit të veturës më së largu 3 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. (brenda muajit shkurt 2024)



SOS FSHATRA
TË FËMIJËVE
KOSOVË

Ofertuesi së bashku me ofertën duhet të dorëzojë:

- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit/ NUI
- Çmimet duhen të kuotohen në euro pa tvsh (duke përfshirë të gjitha shpenzimet tjera përcjellëse nëse ka).
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur /apo në letër me logo zyrtare
- Dëshmi/ Autorizimi që jeni shitës/ qiradhënës dhe servis i autorizuar nga prodhuesi i automjeteve

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë (30 ditë) nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë

Kriteret e përzgjedhjes së ofertës janë si vijon:

- 1. Plotësimi i specifikacionit të kërkuar**
- 2. Pas plotësimit të specifikacionit çmimi më i lirë**

Me rastin e nënshkrimit të kontratës ofertuesi i përzgjedhur duhet të dorëzojë prova se personi përgjegjës dhe pronari i biznesit nuk janë nën hetime për vepra penale/ ose vërtetimin tatimor.

Ofertuesit e interesuar mund t'i dorëzojnë dokumentet dhe ofertën e mbyllur në pliko/ zarf (2 kopje), të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor dhe të shënuara me kodin “ **Oferta për Qiradhënje- Veturë**”. Ofertat duhet të dorëzohen deri me datën: **08.02.2024 në zyret e SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë**, në adresën **Velani 1 Tetori, p.n. Prishtinë** çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00.